



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:303569
Datë: 13.12.2024
Numri i dokumentit: 06595197

C.nr.10049/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI CIVIL, me gjyqtaren Fatbardha Uka Ibrahim, duke vendosur në çështjen juridike të paditëses J.M.B., nga Gj., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Av. A.G., nga P., kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë-Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës me seli në Prishtinë me objekt kontesti, kompensim i pagës së trembëdhjetë, jashtë seance më datë 13.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET se është tërhequr padia C.nr.10049/2023, e datës 26.12.2023, e ushtruar nga paditësja, J.M.B., kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë-Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës me seli në Prishtinë për kompensimin e pagës së trembëdhjetë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja J.M.B., përmes të autorizuarit të saj, ka ushtruar padi pran kësaj Gjykate me datë 26.12.2023, kundër të paditurës, Ministria e Shëndetësisë-Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës me seli në Prishtinë për kompensimin e pagës së trembëdhjetë.

Gjykata lidhur me këtë lëndë, i ka dërguar të autorizuarit të paditëses vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për padi, i njëjti e ka pranuar me datë 27.2.2024, me çka konstatohet nga fletëkthesa, por nuk e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për padi edhe pas kalimit të afatit 15 ditor.

Duke marrë parasysh faktin se paditësit nuk e kanë bërë pagesën e taksës gjyqësore për padinë e parashtruar dhe nuk ekzistojnë kushtet për lirim nga detyrimi i pagimit të së njëjtës, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, duke u bazuar në nenin 253 par. 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI CIVIL
C.nr. 10049/2023, datë 13.12.2024

Gjyqtarja
Fatbardha Uka Ibrahim

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.